



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1397/1 Prot.

Tiranë, më 11 / 10 / 2018

V E N D I M

Nr. 197, Datë 11 / 10 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.77, datë 30.05.2018 të paraqitur nga N.M, kundër ish Kancelarit dhe Administratorit të Universitetit të Tiranës në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “çdo shkak tjetër¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues informon se me Vendimin nr.100, datë 14.06.2017 të Rektorit të Universitetit të Tiranës është komanduar në pozicionin e punës “Drejtores e Drejtorisë Juridike” dhe ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar nga data 19.06.2017 deri në përfundim të procedurave të konkursit për atë vend pune. Gjatë gjithë periudhës e në vijim ka kryer detyrat funksionale të caktuara dhe të parashikuara në kontratën e punës por që nga ana e ish Kancelarit dhe më pas nga Administratori, nuk është paguar për punës e kryer që prej datës 19.06.2017 dhe shkak për moskryerjen e pagesës ka qenë ish-Kancelari dhe Administratori i UT-s, të cilët në cilësinë e “Nëpunësit Autorizues” për Rektoratin e UT-së, nënshkruanin urdhër shpenzimet e pagave të punonjësve, duke rihartuar vetë si listëprezencat ashtu edhe listëpagesat, duke e hequr rregullisht prej tyre me pretendimin se kontrata ishte e paligjshme, duke e trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me punëmarrësit e tjerë që paguheshin për punën e kryer.

Në këto kushte, NM informon se është ndodhur në një situatë të padrejtë, diskriminuese për shkak të trajtimit të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë. Për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje, ankuesja i është drejtuar dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me Vendimin nr.10251, datë 04.12.2017 (vendim i formës së prerë në datë 20.12.2017) ka vendosur detyrimin e UT-s që

¹ Këtu ankuesja ka cituar konfliktin e krijuar mes ish –Kancelarit dhe më pas, Administratorit të Universitetit të Tiranës, lidhur me pretendimin për kompetencat e këtij të fundit dhe Rektorit të UT-së. Ky konflikt ka përfshirë edhe subjektin ankues, duke qenë e punësuar dhe personel në varësi të Rektorit të UT-s.

të paguajë pagën mujore sipas nenit 7 të Kontratës Individuale të Punës, datë 19.06.2017, për punën e kryer nga paditësja si Drejtore në Drejtorinë Juridike, duke filluar nga data 19.06.2017 e në vazhdim të ushtrimit të detyrës, vendim i cili është ekzekutuar nga zyra përmbarimore në datë 06.04.2018.

Gjithashtu NM shpjegon se Administratori e ka përjashtuar edhe nga lista e punonësve që kanë marrë shpërblim për punën e kryer në vitin 2017, në një kohë që këtë shpërblim, administratori ia akordoi vetes të plotë, megjithëse kishte vetëm disa ditë punë të kryera pranë UT-së për vitin 2017.

Subjekti ankues informon se nga ana e Administratorit, i janë krijuar edhe pengesa në ushtrimin e detyrës, duke i bërë vazhdimisht presion me akuzën se kontrata e saj ishte e paligjshme e duke i kërkuar lirimin e zyrës si dhe i janë bërë kanosje dhe akuza poshtëruese në mënyrë të vazhdueshme me pretekstin se sipas administratorit ankuesja ishte duke kryer vepër penale për shkak të ushtrimit pa të drejtë të detyrës, fakt i cili provohet me shkresat² e shumta të hartuara nga ana e Administratorit. Ankuesja pretendon se për shkak të kësaj sjelljeje dhe veprimeve është shqetësuar shumë, duke iu krijuar vazhdimisht gjendje pasigurie dhe mungesë mjedisi të qetë në punë.

Subjekti ankues shpjegon se, ish-Kancelari ashtu dhe Administratori trajtimin e kundërligjshëm e kanë kryer vetëm ndaj nëpunëseve femra dhe jo ndaj nëpunësve meshkuj, me të cilët duket se kanë gjetur gjuhën e përbashkët, fakt i cili provohet me vendimet përkatëse të Rektorit, nga të cilët rezulton se në të njëjtën kohë me NM, janë emëruar në detyrë dhe disa punonjës/e të tjerë, por si ish Kancelari dhe Administratori kanë paguar dhe paguajnë rregullisht vetëm personin mashkull të emëruar, ndërsa punonjëset femra (të cilat ndodheshin edhe në të njëjtin vendim emërimi si punonjësi mashkull), pësuan të njëjtin trajtim të pabarabartë sikurse dhe NM.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ndalimin e shqetësimit në kryerjen e detyrave të ngarkuara³.

Më shkresën protokolluar me tonë nr.782/2, datë 14.06.2018, subjekti ankues ka dërguar informacion dhe dokumentacion plotësues në lidhje me pretendimet e paraqitura.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

² Shkresat nr.820, datë 16.02.2018 dhe nr.820/1, datë 21.02.2018.

³ Referuar procesverbalit datë 01.06.2018.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, NM, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

- A. Me shkresën nr.782/1, datë 13.06.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion Administratorit të UT-së në lidhje me ankesës për pretendim për diskriminim të paraqitur nga ankuesja NM.

Me shkresën nr. 2990/1, datë 22.06.2018, Administratori i UT-së në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se, një ndër detyrat me të cilat Bordi i Administrimit ka ngarkuar Kancelarin, ka qenë dhe administrimi i personelit administrativ, si dhe nënshkrimi i kontratave të punës me ta, pas miratimit të pozicioneve të punës dhe kriterëve nga Bordi. Ish Kancelari, RS ka mbajtur një korrespondencë me Rektorin, në të cilën i parashtronte se punësimet që ky i fundit ka kryer gjatë asaj kohe kanë qenë të kundraligjshme, të kryera nga një autoritet jokompetent, pa konkurim publik siç parashikon neni 67 i ligjit për arsimin e lartë, pa shpallur kriteret dhe procedurat siç përcakton neni 49, pika 1/f të ligjit, në kompetencë të Bordit të Administrimit. Sa më sipër, Administratori i ngarkuar në detyrë me shkresat nr.4511, datë 25.10.2017 dhe nr.4644, datë 02.11.2017 ka urdhëruar shkëputjen e ankueses nga listëpagesat. Për shkak të NM dhe disa punonjës të tjerë, të së njëjtës situatë, të gjithë punonjësit e Rektoratit dhe personeli akademik i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve Universitare të UT-s nuk kanë marrë pagat mujore për 3 muaj rresht dhe është dashur ndërhyrje nga jashtë institucionit për zgjidhjen e situatës. Si Administrator i emëruar sipas Vendimit nr.26, datë 07.12.2017 të Bordit të Administrimit ka gjetur situatën e sipërpërmendur dhe me anë të disa shkresave i është drejtuar Rektorit për ti kërkuar rregullimin e paligjshmërisë dhe të situatës juridike të punonjësve të marrë në punë sipas procedurave jo të rregullta. Me shkresat nr.820, datë 16.02.2018 dhe nr.820, datë 21.02.2018 Administratori i ka kërkuar ankueses të lirojë ambientet e zyrës dhe të dorëzojë regjistrat e urdhrave të brendshëm. Gjatë kësaj periudhe, nga ana e MASR është kryer inspektimi i veprimtarisë së institucionit në përputhje me ligjin dhe është gjetur si shkelje, edhe punësimi i

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

NM, për shkaqet e përmendura më lart sipas projekt-raportit nr.3411/1, datë 30.03.2018. Rektori gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar konkurs për pozicionin e punës së Drejtorit Juridik, në të cilin ka konkuruar si kandidatë e vetme NM dhe ka fituar. NM i është lidhur kontratë 3 mujore pune, e paraqitur për zbatim tek administratori me Vendimin nr.31, datë 09.03.2018, i cili është zbatuar nga ana e Administratorit. NM gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2017 ka zhvilluar një proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “detyrim dhënie pagash” në të cilën ka marrë vetë pjesë si paditëse dhe e paditur, ka fituar dhe nuk ka lejuar ankimimin e çështjes në shkallë të dytë të gjyqësorit. Lidhur me gjykimin e zhvilluar, nga ana e përmbartës është paraqitur për ekzekutim vendimi, i cili është zbatuar sapo është miratuar buxheti i vitit 2018 të Universitetit të Tiranës nga Bordi i Administrimit, referuar shkresës nr.1403/1, datë 06.04.2018.

Lidhur me pretendimin e ankueses për shqetësim në mjediset e punës, Administratori UT-s sqaron se: *“Nga momenti i marrjes së detyrës në datë 10.12.2017 e në vijim, nuk ka pasur asnjë komunikim, takim, diskutim, debat apo kontradiktë me NM. Shkresat e dërguara ankueses në përmbajtje të tyre nuk kanë asnjë shprehje diskriminuese por vetëm kërkesë ligjshmërie. Në momentin që kontrata e punës erdhi pas një procesi konkursi të hapur publik, NM i filloi trajtimin me pagë normalisht, si të gjithë punonjësve të tjerë. Nga ana e Administratorit, në mënyrë të vazhdueshme i është kërkuar Rektorit të zhvillojë konkurse për NM dhe punonjësit e tjerë në të njëjtën situatë si ajo dhe vetëm pas kontrollit të MASR në muajin Mars 2018, Rektori i ka zhvilluar ato”.*

Lidhur me pretendimin e ankueses për trajtim të pabarabartë ndaj nëpunësve meshkuj, Administratori sqaron se: *“Nga momenti i marrjes së detyrës ka gjetur një problematikë të mbartur për rastin e NM dhe tre punonjëse të tjera të emëruara në të njëjtën kohë me të, për të cilat nga ana e Bordit të Administrimit dhe ish Kancelari në detyrë, i janë parashtruar si problematikë. Duke qenë i ri në detyrë, nuk ka pasur asnjë tagër të analizojë veprimet e pararendësit apo organit epror, Bordit të Administrimit, të marra përpara emërimit të tij. Me sa duket pretendimi i ankueses ka të bëjë me E.S, i cili ka filluar detyrën që në vitin 2016, si Drejtor i Komunikimit në Rektoratit e UT-s, pra përpara se Kancelari të ngarkohej me detyra të Administratorit sipas ligjit të ri”.*

Lidhur me pretendimin se Administratori e ka përjashtuar nga lista e punonjësve që kanë marrë shpërblim në vitin 2017, Administratori sqaron se: *“NM nuk e ka gjetur në listëprezencat dhe listëpagesat e punonjësve në kohën e marrjes së detyrës, ndaj për pasojë do të përbënte shkelje nëse do miratoja shpërblim për një punonjës që nuk është i punësuar dhe nuk paguhet në Rektoratit e UT-s”.*

B. Me shkresën nr.2990/2, datë 09.07.2018, Rektori i Universitetit të Tiranës në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Bazuar në pikën 12 të nenit 39 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH” në Statutin dhe Rregulloren e brendshme të UT-s, Rektori ka qenë dhe është i vetmi autoritet që njihet nga ligji për të krijuar marrëdhënie pune në UT. Mbështetur në sa më sipër, me Vendimin nr.100, datë 14.06.2017 të Rektorit është bërë dhe komandimi në vendin e lirë të punës së Drejtores së Drejtorisë Juridike deri në zhvillimin e*

procedurave të konkursit për këtë vend pune i ankueses NM. Ish/Kancelari dhe Administratori aktual për shkak të pozicionit të tyre si Nëpunës Autorizues për Rektoratin e UT-s, nuk kanë paguar ankuesen, tre punonjëse të tjera femra të emëruara në atë kohë nga Rektori (S.Ç, L.G, L.M) dhe dy punonjëse të tjera femra (D.P-Drejtores e Burimeve Njerëzore dhe I.K-Drejtores e Auditit të Brendshëm) duke i'u mohuar të drejtën për tu paguar për punën e kryer muaj me rradhë. Si ish Kancelari ashtu dhe Administratori kanë pretenduar se kontrata e punës së ankueses dhe kontratat e punës së punonjëseve të tjera femra ishin të paligjshme. Sqarojmë Komisionerin se, kompetenca për të disponuar lidhje të marrëdhënies të punës në UT i është njohur vetëm autoritetit të Rektorit. Si rregull, si ish Kancelari ashtu dhe Administratori aktual, në cilësinë si Nëpunës Autorizues, duhet të kryenin pagesat e pagave bazuar në listëprezencat dhe listëpagesat e pagave të hartuara dhe të nënshkruara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe nga Nëpunësi Zbatues, referuar pikës 69 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Por, ndonëse ankuesja dhe punonjëset e tjera femra kanë figuruar rregullisht në listëprezencat dhe listëpagesat e hartuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ish Kancelari dhe Administratori, rihartonin listëpagesat duke i shkëputur këto punonjëse prej tyre. Për këtë veprim, është bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë Tiranë”.

C. Me shkresën protokolluar me tonën nr.782/5, datë 18.07.2018, subjekti ankues në mes të tjerash ka sqaruar se: “Ish Kancelari dhe Administratori i UT-s i kanë funksionet të përcaktuara shprehimisht në nenin 52 të ligjit 80/2015 dhe në asnjë pikë të këtij neni nuk parashikohet kompetenca e Administratorit për të kundërshtuar apo për të mos njohur vendimet e Rektorit. Kategorizimi, pra ndarja e strukturave, të cilat sipas ligjit 80/2015 konsiderohen personel ndihmësakademik me karakter administrativ dhe ato të cilat konsiderohen personel administrativ janë bërë vetëm me Udhëzimin nr.27, datë 29.12.2017 të MASR “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”. Deri në daljen e udhëzimit 27/2017 të gjithë punonjësit e Universitetit të Tiranës përbënin personelin e UT-s dhe për të gjithë personelin e UT-s, sipas nenit 30/12 të ligjit 80/2015 dhe nenit 25/8 të Statutit të UT, kontratat e punës nënshkruhen vetëm nga Rektori. Në lidhje me shkeljen e konstatuar në projekt raportin nr.3411/1, datë 30.03.2018 të MASR për punësimin e NM, saktësohet se dokumenti i cituar është një projekt raport ndaj të cilit UT me shkresën nr.846/5, datë 13.04.2018 ka përcjellë observacionet përkatëse, në vijim të të cilave deri më sot nuk ka mbërritur asnjë raport përfundimtar nga ana e MASR. Gjithashtu, lidhur me procedurat e konkursit për pozicionin e Drejtorit Juridik, referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve, rezulton se për këtë vend pune kanë aplikuar 3 kandidatë. Referuar rastit të punonjësit mashkull të emëruar pothuajse në të njëjtën periudhë, mbetet fakt i provuar që ai ka lidhur kontratë pune në atë periudhë pas konkursit të zhvilluar në të njëjtën ditë me koleget femra të cilat nuk janë paguar as nga ish Kancelari dhe as nga Administratori”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe të disfavorshëm të ankueses nga ish Kancelari dhe Administratori aktual i UT-së.

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës së shtetasës NM, rezulton se me Vendimin nr.100, datë 14.06.2017 të Rektorit të Universitetit të Tiranës, NM është komanduar në pozicionin e punës si Drejtore e Drejtorisë Juridike pranë Universitetit të Tiranës, dhe ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar nga data 19.06.2017 deri në përfundim të procedurave të konkursit për atë vend pune. Me Vendimin nr.31, datë 09.03.2018 NM në përfundim të procedurave të konkurimit është emëruar në pozicionin e Drejtores së Drejtorisë Juridike në Rektoratin e UT-s.

Gjatë gjithë periudhës nga emërimi i NM mes ish Kancelarit të UT-s dhe Rektorit ka patur mosdakordësi në lidhje me kompetencat e emërimit të personelit të Rektoratit, gjë që ka çuar në mos kryerjen e pagesës për një periudhë të gjatë të të gjithë personelit të Rektoratit të UT-s dhe jo vetëm të personelit femër.

Referuar Vendimit nr.10251, datë 04.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (i cili ka marrë formë të prerë në datë 19.12.2017) gjykata ka konsideruar se kontrata e lidhur mes Rektorit të UT-s dhe ankueses ka qenë e rregullt dhe ka vendosur detyrimin e Universitetit të Tiranës për t'i paguar NM pagën mujore duke filluar nga data 19.06.2017 e në vazhdim të ushtrimit të detyrës.

SD është emëruar në detyrën si Administrator i UT-s sipas Vendimit nr.26, datë 07.12.2017 të Bordit të Administrimit (filluar marrëdhëniet e punës në datë 11.12.2017) dhe ka konstatuar situatën e mosdakordësisë mes strukturave drejtuese të UT-s, dhe për këtë fakt ka patur një korrespondencë shkresore mes Rektorit dhe Administratorit për rregullimin situatës së trashëguar në lidhje me kompetencën për emërimin e personelit të UT-s.

Situata e krijuar mes drejtuesve të Universitetit të Tiranës është bërë objekt i kontrollit dhe nga ana e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë, e cila me Urdhrin nr.77, datë 16.02.2018 ka ngritur grupin e punës për kontrollin e paligjshmërisë së veprimtarisë së UT-s me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sipas këtij projekt-raportit nr.3411/1, datë 30.03.2018 nga ana e MASR është gjetur si shkelje dhe punësimi i NM. Universiteti i Tiranës duke mos rënë dakord me projekt raportin, me shkresën nr.846/5, datë 13.04.2018 ka përcjellë observacionet përkatëse por që nuk ka marrë asnjë raport përfundimtar nga ana e MASR.

Me Vendimin nr.39, datë 04.04.2018 Bordi i Administrimit të UT-s ka miratuar buxhetin e Universitetit për vitin 2018 dhe Administratori i UT-s me Urdhër Pagesën nr.1026/4, datë 05.04.2018 ka kryer pagesën për N.M sipas vendimit të gjykatës.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se konflikti institucional lidhur me ndarjen e kompetencave mes Rektorit të UT-së, ish-Kancelarit dhe Administratorit aktual rezulton i provuar nga dokumentacioni shkresor i depozituar në dosje dhe është i pranuar nga të dyja palët.

(një fakt i tillë është argumentuar dhe në Vendimin nr.145, datë 02.07.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me ankesës e A.B kundër Rektorit të Universitetit të Tiranës).

Komisioneri vlerëson se, sjellja dhe veprimet e Administratorit të UT-së ndaj ankueses kanë ardhur si rezultat i faktit që ish Kancelari i UT-s e ka konsideruar punësimin e NM nga ana e Rektorit si të paligjshëm dhe jashtë kompetencave, prandaj dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim si ish Kancelari, por në vijim pas sqarimit të kompetencave sipas Udhëzimit nr.27, datë 29.12.2017 të MASR, Vendimit nr.10251, datë 04.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimin nr.31, datë 09.03.2018 për emërimin e Drejtores së Drejtorisë Juridike dhe Vendimit nr.39, datë 04.04.2018 të Bordit të Administrimit të UT-s mbi miratimin e buxhetit për vitin 2018 të UT-s, situata e pagesës së pagave të punonjësës NM është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se është përjashtuar edhe nga lista e punonësve që kanë marrë shpërblim për punën e kryer në vitin 2017, Komisioneri vlerëson se bazuar në shkresën “Listë emërore për shpërblime të vitit 2017, sipas vendimit të BA nr.27, datë 20.12.2017”, rezulton se shpërblimin e vitit 2017 e kanë përfutur gjithsej 54 punonjës. Nga këta, 20 janë meshkuj dhe 34 janë femra. Pra, nga sa shihet, në dhënien e shpërblimit të fundvitit, gjinia nuk ka shërbyer si kriter favorizues për meshkujt, dhe si rrjellin dhe nuk është dizavantazuar për këtë shkak.

Për sa më sipër, në referencë të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se N.M nuk i është nënshtruar dhe ekspozuar një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit të Universitetit të Tiranës.

Përsa i përket pretendimit të ankueses lidhur me shqetësimin në vendin e punës nga ana e Administratorit të UT-s, duke i kërkuar lirimin e zyrës si dhe duke i bërë kanosje dhe akuza poshtëruese në mënyrë të vazhdueshme me pretekstin se ankuesja ishte duke kryer vepër penale për shkak të ushtrimit pa të drejtë të detyrës, Komisioneri konstaton se, që nga data 20.12.2017 e në vijim, Administratori i UT-s ka qenë në dijeni të Vendimit nr.10251, datë 04.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në të cilin konstatohet rregullsia e marrëdhënieve të punësimit mes Universitetit të Tiranës dhe punonjësës N.M dhe detyrimin e UT-s për kryerjen e pagesës së ankueses sipas kushteve të kontratës. Administratori i UT-s bazuar në këtë vendim të formës së prerë duhet të kishte ndërtuar marrëdhëniet e punësimit mes tij dhe ankueses N.M, duke respektuar kontratën e punës dhe jo duke vazhduar mosnjohjen e Vendimit të Gjykatës dhe duke i kërkuar Drejtores së Drejtorisë Juridike lirimin e mjediseve të zyrës dhe dorëzimin e regjistrit të urdhrave të brendshëm të rektoratit.

Komisioneri vlerëson se Administratori i UT-s pas njohjes me vendimin e gjykatës duhet të kishte marrë të gjitha masat për respektimin e këtij vendimi dhe jo të dërgonte shkresat nr.820, datë 16.02.2018 dhe nr. 820/1 datë 21.02.2018 duke i kërkuar N.M lirimin e mjediseve të punës dhe mos paraqitjen në punë duke e njoftuar për mosnjohjen e kontratës së punës. Nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, veprimet e Administratorit të UT-s, kanë

sjellë për pasojë vendosjen e ankueses në kushte të disfavourshme, duke krijuar një mjedis intimidues dhe gjendje pasigurie në punë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grup personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit të UT-s, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavourshëm të ankuesit.

Ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit të UT-s, për shkak të gjinisë dhe konfliktit institucional mes drejtuesve të UT-s.

Këto janë shkaqe, për të cilin Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Gjatë shqyrtimit të akteve administrative, të depozituara në cilësinë e provës, si dhe duke u mbështetur në Vendimin nr.145, datë 02.07.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me ankesën e A.B kundër Rektorit të Universitetit të Tiranës, Komisioneri ka konstatuar dhe është vënë në dijeni të konfliktit institucional brenda institucionit të Rektoratit dhe specifikisht konfliktit për kompetencë të Rektorit nga njëra anë dhe ish Kancelarit, Administratorit dhe Bordit të Administrimit të UT, nga ana tjetër. Një fakt i tillë është evidentuar përgjatë korrespondencës zyrtare, që Komisioneri ka patur me të dy titullarët e këtij institucioni, si dhe provave respektive⁵ të depozituara nga palët në këtë proces administrativ.

⁵-Kallëzim për ndjekje penale, datë 25.01.2018 e bërë nga S.Ç, L.G, N.M dhe L.M kundër Administratorit të UT-s.

- Kallëzim për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, datë 07.03.2018 të bërë nga Administratori i UT-s kundër Rektorit të UT-s në bashkëpunim me shtetasen N.M.

- Shkresë nr.418, datë 26.01.2018 të bërë nga Administratori i UT-s, drejtuar Rektorit të UT-s mbi punësimet e paligjshme për katër punonjëse.

- Shkresë nr.457, datë 30.01.2018 të bërë nga Administratori i UT-s, drejtuar Rektorit të UT-s mbi punësimet e paligjshme për katër punonjëse.

- Shkresë nr.820, datë 16.02.2018 të bërë nga Administratori i UT-s, drejtuar N.M mbi lirimimin e ambjenteve të zyrës dhe dorëzimin e regjistrimit të urdhrave të brendshëm.

Përsa më sipër, Komisioneri vlerëson se konflikti institucional lidhur me ndarjen e kompetencave mes Rektorit të UT-së, dhe Administratorit të UT-s rezultojnë i provuar nga dokumentacioni shkresor i depozituar në dosje dhe është i pranuar nga të dyja palët. (një fakt i tillë është argumentuar dhe në Vendimin nr.145, datë 02.07.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me ankesën e A.B kundër Rektorit të Universitetit të Tiranës).

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Gjatë shqyrtimit të të gjithë akteve administrative, të depozituara në cilësinë e provës, si dhe duke u mbështetur në korrespondencën zyrtare, që Komisioneri ka patur me të dy titullarët e këtij institucioni (Rektorit dhe Administratorit), rezultojnë se Administratori i UT-s nuk ka rënë dakord mbi ndarjen e kompetencave të tyre, të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

1. Sa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim për shkak të gjinisë, në lidhje me mospagimin e pagave dhe dhënies së shpërblimit të fundvitit, Komisioneri vlerëson se ankuesja duhet të sillte prova dhe fakte dhe të identifikonte një krahasues për të provuar se mospagimi i pagave të saj ka ardhur si rezultat i gjinisë së saj dhe se punonjësit meshkuj të ndodhur në të njëjtën situatë me ankuesen janë trajtuar ndryshe duke iu respektuar marrëdhëniet e punësimit.

Gjithashtu lidhur me pretendimin se është trajtuar ndryshe në raport me punonjësit meshkuj, dhe në rastin konkret në raport me Drejtorin e Drejtorisë së Komunikimit, Komisioneri vëren se marrëdhëniet e punësimit⁶ të punonjësit E.S me Universitetin e Tiranës kanë filluar që në datë 20.06.2016, rreth një vit më parë se ankuesja, pra dhe si rrjedhim ankuesja dhe krahasuesi nuk ndodhen në të njëjtat kushte dhe për këtë arsye nuk mund të merret si bazë krahasimore.

Gjatë trajtimit të ankesës së NM, u administruan prova se ka patur një situatë paligjshmërie nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit, lidhur me mos pagimin e pagave të punonjëses N.M të konstatuar si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë po ashtu dhe nga Avokati i Popullit⁷, por nuk u siguruan prova apo informacion për të provuar se mos pagimi i pagave dhe dhënia e shpërblimit të fundvitit nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit është bërë për shkak të gjinisë së ankueses.

2. Përsa i takon pretendimit për shqetësim në marrëdhëniet e punësimit nga ana e Administratorit të UT-s, Komisioneri konstaton se, që nga data 20.12.2017 e në vijim, Administratori i UT-s ka qenë në dijeni të Vendimit nr.10251, datë 04.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në të cilin konstatohej rregullsia e marrëdhënieve të punësimit mes Universitetit të Tiranës dhe punonjëses N.M dhe detyrimin e UT-s për kryerjen e pagesës së

- Shkresë nr.820/1, datë 21.02.2018 të bërë nga Administratori i UT-s, drejtuar N.M mbi lirimimin e ambjenteve të zyrës dhe dorëzimin e regjistrimit të urdhrave të brendshëm.

- Shkresë nr.942, datë 23.02.2018 të bërë nga Administratori i UT-s, drejtuar Rektorit të UT-s mbi punësimet e paligjshme të kryera.

⁶ Referuar shkresës nr.2101, datë 20.06.2016 “Për komandimin e drejtorit të Drejtorisë së Komunikimit në Rektorat” dhe vazhdimin e marrëdhënies së punësimit me Vendimin nr.141, datë 19.09.2017 “Për përsëritjen e kontratave të punës me afate të përcaktuara të punonjësve jomësimor në Rektoratin e UT-s”.

⁷ Shkresa nr. K1/S3-6, datë 13.03.2018.

ankueses sipas kushteve të kontratës dhe bazuar në këtë vendim të formës së prerë duhet të kishte ndërtuar marrëdhëniet e punësimit mes tij dhe ankueses N.M, duke respektuar marrëdhëniet e punësimit dhe jo duke vazhduar mosnjohjen e Vendimit të Gjykatës dhe duke i kërkuar Drejtores së Drejtorisë Juridike lirimin e mjediseve të zyrës dhe dorëzimin e regjistrit të urdhrave të brendshëm të rektoratit. Në kushtet kur punonjësja dhe raporti i saj i punës ishte i njohur si i rregullt dhe i ligjshëm nga një vendim gjykate që kishte marrë formën e prerë, vendi i punës i ankueses duhej konsideruar i padiskutueshëm dhe asnjë veprim kundërshtues nuk duhej të ishte ndërmarrë.

Për sa më sipër, rezulton qartë se N.M është cilësuar si punonjëse, që bën pjesë në grupin mbështetës të Rektorit të UT-s dhe Komisioneri vlerëson se shkresat e Administratorit të UT-s drejtuar ankueses në të cilat i bëhet presion për lirimin e mjediseve të punës me pretekstin se ankuesja ishte duke kryer vepër penale për shkak të ushtrimit pa të drejtë të detyrës e kanë vendosur N.M në kushte të disfavorshme, duke cenuar dinjitetin e saj dhe duke i krijuar një mjedis intimidues dhe gjendje pasigurie në punë për shkak se është konsideruar si përkrahëse e Rektorit të Universitetit të Tiranës (përkatësia në një grup të veçantë).

Parimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë, sanksionohet dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e cila në nenin 142/3 të saj ka parashikuar se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*.

Kodi i Punës, në nenin 9/1 ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Gjithashtu, në pikën 1/c, të nenit 32, të tij ka parashikuar se: *“Punëdhënësi ka detyrimin të respektojë dhe të mbrojë në raportet e punës personalitetin e punëmarrësit, si dhe: c) parandalon çdo qëndrim që cenon dinjitetin e punëmarrësit”*.

Në nenin 3/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Në nenin 3/5 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *““Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqtësor, përçmues, poshtëruar a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë”*.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se, shtetasja NM është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues në formën e shqetësimit nga ana e Administratorit të UT-s për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1/5, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasës N.M nga ana e Administratorit të UT-s, për shkak të gjinisë.
2. Konstatimin e diskriminimit në formën e shqetësimit të shtetasës N.M nga ana e Administratorit të UT-s, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.
3. Në referim të pikës 1, Administratori i UT-s, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrë masa për ndalimin e shqetësimit të punonjësës N.M.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Administratori i UT-s, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(shkaku: perkatesia në një grup të veçantë)
(fusha: te mira dhe sherbime)